



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
**Drejtoria e Administratës Zgjedhore**

Data	
Nr.	Prot.

**RELACION**  
**PËR**

**MIRATIMIN E RAPORTIT MBI GJETJET E KËQYRJES SË MËPASSHME TË FLETËVE TË VOTIMIT DHE E TË MATERIALIT ZGJEDHOR TË PËRDORURA NGA KOMISIONET ZGJEDHORE NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14.05.2023 DHE PËR ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS TË DATËS 24.09.2023.**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njej shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Neni 167/2 i Kodit Zgjedhor përcakton këqyrjen e mëpasshme të fletëve të votimit dhe të materialit zgjedhor, me qëllim verifikimin e rregullsisë dhe saktësisë së veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit e numërimit të votave.

Në zbatim të sa më sipër, është miratuar vendimi nr. 800, nr. 800, datë 20.10.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Përzgjedhja e qendrave të votimit ishte rastësore dhe u bë me short. Në listën e QV-ve për të cilat u hodh short nuk u përfshinë ato të këqyrura nga KAS gjatë procesit ankimor për të dyja organet (5 QV në total), ndërsa QV të cilat u këqyrën për njërin prej organeve u përfshinë në short për t’ju nënshtruar verifikimit për organin e paankimuar/ pakëqyrur më parë.

Më 23 Tetor 2023, u hodh short ndërmjet 5208 qendrave të votimit nga 5213 në total dhe në përfundim të tij, u përzgjedhën 526 qendra votimit që përfaqësojnë 10% të qendrave të votimit për çdo KZAZ. Rezultatet e shortit u miratuan nga Komisioneri me vendimin nr. 813, datë 23.10.2023 “Për miratimin e rezultatit të shortit për përzgjedhjen e Qendrave të Votimit që do t’i nënshtrohen procesit të këqyrjes paszgjedhore, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”.

## II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Procesi i këqyrjes paszgjedhore u zhvillua nga data 6 në 26 Nëntor 2023, ku u verifikuan 526 qendra votimi, përfaqësuese e 10% të totalit. Kjo këqyrje synoi të vlerësonte rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore, duke përfshirë numërimin e votave dhe administrimin e procesit për çdo qendër votimi.

Për bashkinë Kukës, në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme për kryetarin e bashkisë, të njëjtat QV të përzgjedhura për këqyrjen në kuadër të zgjedhjeve të përgjithshme vendore të 14 Majit 2023, iu nënshtruan verifikimit edhe për zgjedhjet e datës 24.9.2023.

Për këqyrjen e fletëve të votimit dhe materialeve të votimit për 526 QV-të u ngritën 8 grupe për këqyrje, të cilët vlerësuan dhe plotësuan procesverbalet përkatëse për administrimin e informacionit.

Të dhënat e pasqyruara në procesverbalet përkatëse të këqyrjes u përpunuan dhe u analizuan. Në kuadër të procesit të analizës së gjetjeve, u konstatuan shkelje administrative.

Në zbatim të nenit 77 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, administrata e KQZ-së në vijim të procesit të hetimit administrativ, vijoi me evidentimin e personave pjesë e administratës zgjedhore për secilin prej rasteve të evidentuar me problematika.

Secilit prej personave, pjesë e administratës zgjedhore, iu komunikuan gjetjet nga procesi i këqyrjes dhe u kërkuan shpjegime/argumente nga ana e tyre me qëllim vlerësimin e të gjitha rrethanave të nevojshme për vlerësimin përfundimtar. Informacioni ju është dërguar shkresërisht dhe/ose nëpërmjet platformave të komunikimit social whatsapp/postë elektronike (e-mail).

Në përfundim u ballafaquan të dhënat nga gjetjet e këqyrjes me shpjegimet e dhëna nga personat e identifikuar me shkelje, dhe u përgatit ky raport.

Projektraporti është organizuar në 4 krerë dhe trajton respektimin nga ana e komisioneve të qendrave të votimit të kërkesave procedurale gjatë procesit të votimit si dhe të saktësisë së veprimeve të grupeve të numërimit të votave përgjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave.

Kreu I përshkruan metodat e përdorura për administrimin e të dhënave dhe identifikimin e problematikave.

Kreu II është i organizuar në 3 seksione dhe jep një paraqitje statistikore të pyetësorit lidhur me përmbushjen e detyrave ligjore dhe nënligjore nga administrata zgjedhore.

**Seksioni 1** në këtë kre, trajton vendimmarrjet e komisioneve të qendrave të votimit dhe administrimin e tyre në dokumentacionin e punës. Në këtë seksion paraqiten të dhëna statistikore për administrimin e procesverbaleve dhe raporteve të hapjes dhe mbylljes së votimit, si dhe sfidat e identifikuar në administrimin e materialeve zgjedhore.

**Seksioni 2** fokusohet në administrimin e bazës materiale zgjedhore, duke përfshirë vulat e komisionit të qendrës së votimit dhe përdorimin e zarfeve specifike.

**Seksioni 3** verifikon saktësinë e veprimtarisë së grupeve të numërimit gjatë vlerësimit dhe numërimit të votave.

Seksioni 4 pasqyron të dhëna statistikore lidhur me natyrën e pavlefshmërisë së votave të ndara sipas kategorive të përcaktuara në kodin zgjedhor.

Kreu III pasqyron përvojën dhe rezultatet e pilotimit të pajisjeve elektronike në zgjedhjet lokale dhe vlerëson efektivitetin e tyre në procesin zgjedhor.

Kreu IV propozon masa specifike për adresimin e problematikave identifikuar gjatë procesit të votimit dhe numërimit të votave, duke përfshirë ndryshime ligjore, rishikime të procedurave dhe trajnime të administratës zgjedhore.

Projekt raporti u është dërguar për konsultim edhe partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile. Koalicioni për reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ka paraqitur disa vërejtje dhe rekomandime lidhur me projekt raportin

KRIIK rekomandon që KQZ të:

- Adresoje me vendosmëri dhe transparencë të plotë të gjitha gjetjet e procesit të auditimit duke dhënë sqarime lidhur me metodologjinë e përpunimit të të dhënave dhe përcaktimin e standardit si gabim njerëzor të devijimit të votave.
- Marrë masa administrative dhe bëjë kallëzim penal ndaj shkelësve, pa marrë parasysh përkatësinë politike.
- Përfshijë rekomandime të qarta dhe të detajuara në versionin final të Raportit të Auditimit.
- Bëjë një shqyrtim të plotë të rrethanave të pavlefshmërisë së votave, veçanërisht ato që janë bërë të pavlefshme nga mungesa e vulës.
- Ndërmarrë hapa për të mos përsëritur gabimet në proceset e ardhshme zgjedhore, duke përfshirë përmirësimin e trajnimeve për komisionerët.

KRIIK thekson se standardet e vendosura nga KQZ për sanksionimin e komisionerëve në shkelje nuk duhet të zbehen, për të ruajtur integritetin e procesit zgjedhor dhe për të shmangur hapat pas në ligjzbatim.

Administrata e KQZ-së ka vlerësuar, ka analizuar dhe ka shqyrtuar rekomandimet e KRIIK duke pasqyruar shpjegimet e nevojshme për të bërë më shumë transparencë lidhur me përmbajtjen e raportit dhe duke hartuar rekomandime të qarta dhe të detajuara për adresimin e çështjeve të identifikuara gjatë kqyrjes paszgjedhore.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shqyrton dhe miraton projektvendimin “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e organeve të vetëqeverisjes vendore”.

**Erion META** – Drejtoria e Administratës Zgjedhore

**Daniela ALIMEMETI** – Drejtoria e Logjistikës dhe Digitalizimit

**Madalena KOJA** – Drejtoria e Ligjshmërisë

**Majlinda CELMETA** - Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

**Aurel LAMÇE** – Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: ....5.2024

Nr:

Ora: .....

**PROJEKTVENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E RAPORTIT MBI GJETJET KYÇE TË PROCESIT TË KËQYRJES  
PASZGJEDHORE TË FLETËVE TË VOTIMIT, MATERIALIT ZGJEDHOR DHE PAJISJEVE  
TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK (PEVN) TË PËRDORURA NË ZGJEDHJET  
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023, DHE PËR  
ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS TË DATËS 24.09.2023**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “c” e “n”, e 2, 23, pika 8, dhe 167/2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S:**

1. Miratimin e raportit mbi gjetjet nga këqyrja paszgjedhore e fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik të 526 (pesëqind e njëzet e gjashtë) qendrave të votimit, sipas materialit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. T’i kërkoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosjen e sanksioneve administrative ndaj anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave përgjegjës për shkeljet e konstatuara nga këqyrja, sipas listës në lidhjen 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: ...5.2024 Nr: ..  
Ora: 00



“Për miratimin e raportit mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) të përdorura në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24.09.2023”

**RAPORT**  
**MBI GJETJET E KËQYRJES SË MËPASSHME TË FLETËVE TË VOTIMIT DHE E TË**  
**MATERIALIT ZGJEDHOR TË PËRDORURA NGA KOMISIONET ZGJEDHORE NË**  
**ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14.05.2023 DHE PËR**  
**ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS TË DATËS 24.09.2023.**

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



Raport mbi gjetjet e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe e të materialit zgjedhor të përdorura nga komisionet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24.09.2023.

## Tabela Përmbledhëse

HYRJE .....	3
Kreu I: Përshkrim i procesit të administrimit të të dhënave gjatë verifikimit.....	5
1. Përbajtja e të dhënave mbi procesin e vlerësimit të votave.....	5
2. Procesi i plotësimit të procesverbalit standard për administrimin e materialit zgjedhor .....	5
3. Identifikimi dhe analiza e parregullsive.....	5
Kreu II: Verifikimi i saktësisë së administrimit të dokumentacionit zgjedhor dhe numërimit të votave .....	7
Seksioni 1: Të dhëna për vendimarrjet e KQV-ve dhe administrimi i tyre në dokumentacionin e punës .....	7
Seksioni 2. Administrimi i bazës materiale zgjedhore .....	12
Seksioni 3. Verifikimi i saktësisë së veprimtarisë së grupeve të numërimit përgjatë vlerësimit e numërimit të votave .....	14
Seksioni 4: Votat e pavlefshme dhe natyra e pavlefshmërisë.....	15
Kreu III: Pilotimi i Pajisjes Elektronike të Votimit dhe Numërimit .....	17
Kreu IV: Rekomandime .....	17
Seksioni 1: Masa për adresimin e problematikave të identifikuara gjatë procesit të votimit dhe numërimit të votave .....	17
Seksioni 2: Masa për përmirësime ligjore dhe akteve nënligjore.....	19
Aneksi nr. 1: Qendrat e Votimit të përzgjedhura me short .....	20
Aneksi nr. 2: KQV të evidentuara me mosplotësi apo mungesë të miradministrimit të dokumentacionit të punës .....	33
Aneksi nr. 3: Gjetjet e grupeve të këqyrjes për diferencat e mëdha për QV .....	35
Aneksi nr. 4: Grupet e numërimit të votave përgjegjëse për shkeljet e konstatuara në kreun II për saktësinë e numërimit të votave për subjekte/ kandidatë .....	43

## HYRJE

Kodi Zgjedhor autorizon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të realizojë procesin e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

Këqyrja e mëpasshme e fletëve të votimit dhe e materialit zgjedhor bëhet për të verifikuar rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit e numërimit të votave.

Bazuar në vendimin nr. 800, datë 20.10.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e organeve të vetëqeverisjes vendore”, administrata e KQZ-së zhvilloi procesin e këqyrjes paszgjedhore, i cili u zhvillua nga data 06.11.2023 deri më 26.11.2023.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 167/2, këqyrjes iu nënshtruan 10% të qendrave të votimit. Nga totali prej 5213 qendra votimi, numri i qendrave të votimit që u verifikuan është 526 QV.

Përzgjedhja e qendrave të votimit ishte rastësore dhe u bë me short. Më 23 Tetor 2023, u hodh short ndërmjet 5208 qendrave të votimit nga 5213 në total dhe në përfundim të tij, u përzgjedhën 526 qendra votimit<sup>1</sup> sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur të këtij raporti, që përfaqësojnë 10% të qendrave të votimit për çdo KZAZ.

Në listën e QV-ve për të cilat u hodh short nuk u përfshinë ato të këqyrura nga KAS gjatë procesit ankimor për të dyja organet (5 QV në total), ndërsa QV të cilat u këqyrën për njërin prej organeve u përfshinë në short për t’ju nënshtruar verifikimit për organin e paankimuar/ pakëqyrur më parë.

Nga 526 QV-të e përzgjedhura 8 QV ishin këqyrur pjesërisht nga KAS (Kutia e Materialeve Zgjedhore 1 QV, Kutia e votimit për kryetar 7 QV), ndërsa në Zonat e Administrimit të Zgjedhjeve ku është implementuar PEVN (pajisja elektronike e votimit dhe numërimit) u përzgjedhën nëpërmjet shortit 40 QV.

Për bashkinë Kukës, në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme për kryetarin e bashkisë, të njëjtat QV të përzgjedhura për këqyrjen në kuadër të zgjedhjeve të përgjithshme vendore të 14 Majit 2023, iu nënshtruan verifikimit edhe për zgjedhjet e datës 24.9.2023.

Për këqyrjen e fletëve të votimit dhe materialeve të votimit për 526 QV-të u ngritën 8 grupe për këqyrje, të cilët vlerësuan dhe plotësuan procesverbalet përkatëse për administrimin e informacionit.

Të dhënat e pasqyruara në procesverbalet përkatëse të këqyrjes u përpunuan dhe u analizuan. Në kuadër të procesit të analizës së gjetjeve, u konstatuan shkelje administrative.

<sup>1</sup> Vendimi nr, 813, datë 23.10.2023 “Për miratimin e rezultatit të shortit për përzgjedhjen e Qendrave të Votimit që do t’i nënshtrohen procesit të këqyrjes paszgjedhore, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”

Në zbatim të nenit 77 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, administrata e KQZ-së në vijim të procesit të hetimit administrativ, vijoi me evidentimin e personave pjesë e administratës zgjedhore për secilin prej rasteve të evidentuar me problematika. Secilit prej personave, pjesë e administratës zgjedhore, iu komunikuan gjetjet nga procesi i këqyrjes dhe u kërkuan shpjegime/argumente nga ana e tyre me qëllim vlerësimin e të gjitha rrethanave të nevojshme për vlerësimin përfundimtar. Informacioni ju është dërguar shkresërisht dhe/ose nëpërmjet platformave të komunikimit social ëhatsapp/postë elektronike (e-mail).

Në përfundim u ballafaquan të dhënat nga gjetjet e këqyrjes me shpjegimet e dhëna nga personat e identifikuar me shkelje, dhe u përgatit ky raport përmbledhës mbi respektimin nga ana e komisioneve të qendrave të votimit të kërkesave procedurale gjatë procesit të votimit si dhe të saktësisë së veprimeve të grupeve të numërimit të votave përgjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave.

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



Raport mbi gjetjet e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe e të materialit zgjedhor të përdorura nga komisionet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24.09.2023.

## Kreu I: Përshkrim i procesit të administrimit të të dhënave gjatë verifikimit

Në këtë kre përshkruhet procesi i administrimit të të dhënave gjatë procesit të verifikimit paszgjedhor, duke përfshirë kategoritë e informacionit të administruar dhe metodat e përdorura për identifikimin dhe analizimin e parregullsive. Grupet e këqyrjes plotësojnë për çdo qendër votimi procesverbalet tip të miratuara me vendimin nr. 800/2023. Informacioni i administruar nga grupet e këqyrjes përmban të dhëna sasiore dhe cilësore.

### 1. Përmbajtja e të dhënave mbi procesin e vlerësimit të votave

Grupet e këqyrjes kanë rinumëruar votat për secilën qendër votimi, për kandidatët për kryetar bashki dhe për subjektet zgjedhore. Informacioni i administruar nëpërmjet procesverbaleve për procesin e vlerësimit të votave, përfshin të dhëna sasiore dhe cilësore, duke filluar nga saktësia e rezultateve të vlerësimit të votave për kandidatët dhe subjektet zgjedhore dhe identifikimi i natyrës së pavlefshmërisë së votave.

Proceset verbale kanë shërbyer për identifikimin e ndonjë parregullsie gjatë procesit të numërimit të votave. Informacioni është përpunuar në sistem për çdo qendër votimi për të treguar numrin e votave për secilin kandidat dhe subjekt, si dhe diferencën mes tyre.

Gjithashtu, është bërë rivlerësim i rezultateve për kandidatët për kryetar bashkie dhe subjektet zgjedhore për secilën zonë zgjedhore për këshillin e bashkisë për të kuptuar nëse diferencat në rezultat gjeneronin lëvizje të mandatit.

### 2. Procesi i plotësimit të procesverbalit standard për administrimin e materialit zgjedhor

Grupet e këqyrjes për të vlerësuar performancën dhe përputhshmërinë e veprimtarisë së komisioneve të qendrave të votimit kanë shqyrtuar rregullsinë e administrimit të materialeve/dokumentacionit zgjedhor duke plotësuar një procesverbal standard për secilën qendër votimi. Ky procesverbal përmban një pyetësor me 49 pyetje, duke përfshirë aspektet kryesore të administrimit zgjedhor. Procesverbali shërben për identifikimin e parregullsive përgjatë procesit të administrimit të zgjedhjeve nga administrata zgjedhore.

Procesverbali është plotësuar nga grupet e verifikimit në format elektronik nëpërmjet platformës *Microsoft Forms* dhe më pas është verifikuar dhe nënshkruar nga personat përgjegjës për verifikimin.

### 3. Identifikimi dhe analiza e parregullsive

Pyetjet dhe përgjigjet e tyre janë administruar për të vlerësuar në mënyrë deduktive dhe indikative treguesit e performancës së administratës zgjedhore gjatë ditës së votimit si dhe për të identifikuar proceset që kanë

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



Raport mbi gjetjet e këqyrjes së mëposhme të fletëve të votimit dhe e të materialit zgjedhor të përdorura nga komisionet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24.09.2023.

nevojë për t'u përmirësuar më tej.

Të dhënat janë administruar në database dhe janë analizuar në nivel makro duke identifikuar problematikat kryesore dhe vendndodhjen e tyre (KQV konkrete). Identifikimi i problematikave ka përfshirë edhe identifikimin e çështjeve apo situatave që krijuan paqartësi nga zbatimi i Kodi Zgjedhor. Analiza është bërë duke kryqëzuar të dhënat me informacionin e disponueshëm nga KQZ për të identifikuar personat përgjegjës për shkeljet e identifikuara.


Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



Raport mbi gjetjet e këqyrjes së mëposhme të fletëve të votimit dhe e të materialit zgjedhor të përdorura nga komisionet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24.09.2023.

## Kreu II: Verifikimi i saktësisë së administrimit të dokumentacionit zgjedhor dhe numërimit të votave

Ky kre përmban një vlerësim të përmbushjes së detyrave themelore ligjore dhe nënligjore nga administrata zgjedhore, bazuar në qendrat e votimit të këqyrura. Rezulton se administrata zgjedhore ka përmbushur detyrat e saj në nivelin mesatar prej 88%<sup>2</sup> nga totali i kërkesave themelore duke u vepruar në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe aktet nënligjore të tij. Kjo shënon një rritje prej 9% në krahasim me rezultatin e këqyrjes së zgjedhjeve për Kuvend të vitit 2021.



### Seksioni 1: Të dhëna për vendimmarrjet e KQV-ve dhe administrimi i tyre në dokumentacionin e punës

Ky seksion përmban një vlerësim të përmbushjes së detyrave themelore ligjore dhe nënligjore nga administrata e qendrave të votimit .

- Procesverbalet dhe raportet e hapjes dhe mbylljes së votimit

Në 95% të qendrave të votimit të këqyrura, komisionet kanë administruar procesverbalet e hapjes dhe mbylljes së procesit të votimit në përputhje me procedurat ligjore nga 91% që ishte raporti i zbatimit të kësaj kërkese në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2021.

Megjithatë, janë identifikuar disa vështirësi lidhur me qëndrueshmërinë e zbatimit të kërkesave procedurale

<sup>2</sup>Kjo vlerë është caktuar në bazë të vlerësimit me peshë të barabarta të 26 aktiviteteve kryesore, të identifikuar gjithashtu në procesverbalin e këqyrjes, që përfshijnë administrimin e procesit në ditën e votimit si dhe saktësinë e numerimit të votave. Secili nga këto 26 aktivitete kryesore (themelore) është pikezuar në bazë të përgjigjes pohuese/mohuese (po/jo) dhe është përcaktuar në vlerë numerike për çdo qendër votimi. Vlera numerike është kthyer në vlerë në përqindje për secilin aktivitet për të gjitha qendrat e votimit të këqyrura. Në përfundim është nxjerrë mesatarja e të 26 aktiviteteve së bashku për të gjitha qv e këqyrura, e cila korespondon me vlerën prej 88%.



për procesin e administrimit të materialeve/dokumentacionit të punës së KQV-së.

Në veçanti, është vërejtur mungesa e regjistrimit të vendimmarrjeve të KQV-ve në procesverbalet tip të miratuara nga KQZ dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve (LPM). 11% e QV-ve nuk kanë evidentuar në LPM hapjen e votimit dhe 26 % e KQV-ve nuk kanë evidentuar në LPM mbylljen se votimit.

Procesi i dorëzimit të fletëve të votimit nga KZAZ në KQV dhe pasqyrimi i tyre si në procesverbale edhe në Librin e Protokollit të Mbledhjes nuk ka ndjekur të njëjtin rrjedhë sipas procedurave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, respektivisht në kërkesat e neneve 101 dhe 113 të Kodit Zgjedhor.

Vendimi nr. 11/2021 i Komisionit Rregullator, i ndryshuar, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit”, përcakton se raporti i hapjes dhe ai i mbylljes i gjeneruar nga pajisja PEI nënshkruhet nga anëtarët e KQV-së dhe futet në kutinë e materialeve të votimit (materialet zgjedhore). Administrimi i raporteve të PEI është bërë në mënyrë jo konsistente nga të gjithë KQV-të / operatorët dhe konkretisht në:

1. 16% të qendrave të këqyrura nuk janë administruar raportet e hapjes së votimit
  2. 22% të qendrave të këqyrura nuk janë administruar raportet e mbylljes së votimit
- Vendimet e KQV-ve dhe pasqyrimi i tyre në LPM, procesverbalet për administrimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit

Të dhënat e përpunuara nga procesverbali që administrojnë pyetjet për këtë tregues evidentojnë si më poshtë:

1. Për hapjen e procesit të votimit rezultojnë se:
  - 80% e QV-ve kanë marrë vendim për hapjen e QV në orën 07:00.
  - 5% e QV-ve kanë marrë vendim për hapjen e votimit deri në orën 08:00.
  - 2% e QV-ve kanë marrë vendim për hapjen e votimit deri në orën 10:00.
  - 13% e QV-ve nuk kanë evidentuar me vendimmarrje orarin e hapjes së votimit.
2. Për mbylljen e procesit të votimit rezultojnë se:
  - 69% e QV-ve kanë marrë vendim për mbylljen e votimit në orën 19:00.
  - 4% e QV-ve kanë marrë vendim për mbylljen e votimit deri në orën 19:30.
  - 27% e QV-ve nuk kanë evidentuar me vendimmarrje orarin e mbylljes së votimit.
3. 72% e vendimeve të QV-ve janë të vulosura me vulën e KQV-së.
4. Në 8% të QV-ve janë evidentuar vendimmarrje për pezullimin e procedurës së votimit për arsye të ndryshme.
5. Në 12% të QV-ve janë evidentuar problematika lidhur me funksionimin/mungesën e operatorëve/mosfunksionimin e PEI-t.
6. Në 12 QV është konstatuar se procedura ka kaluar manualisht me listën e zgjedhësve për shkak të mungesës së operatorit PEI-t.
7. Në 11 % të QV-ve ka filluar procedura e votimit manualisht dhe më pas ka kaluar me përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit (PEI) dhe në 9% të QV-ve komisionet e qendrave të votimit kanë vendosur të vijojnë procedurën manualisht për shkak se pajisja PEI nuk ka funksionuar për më shumë se 3 orë.
8. Në 1% të rasteve është kërkuar ndërhyrja e policisë në QV.
9. Në 1 QV vëzhguesit kanë paraqitur vërejtje.

Nenet 41 dhe 42 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë detyrat e Sekretarit të KQV-së dhe vendimmarrjet e komisionit të qendrës së votimit, ndërsa nenet 101 – 114 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë detyrat dhe rregullat për procesin e votimit ditën e zgjedhjeve.

Në përfundim të këqyrjes rezultoi se 47 QV nuk kishin administruar apo nuk kishin plotësuar Librin e Protokollit të Mbledhjeve (LPM), të evidentuara si më poshtë vijon:

Nr.	KZAZ	QV	Organi	Mangësia
1	02	0118/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
2	04	0321/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mungon
3	06	0210/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
4	09	0518/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
5	16	0927/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mungon
6	18	1057/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
7	19	1206/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
8	19	1238/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
9	20	1278/01	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
10	20	1285/01	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
11	21	1348/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
12	21	1353/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
13	21	1367/01	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
14	21	1368/01	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mungon
15	22	1419/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
16	30	1624/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim

17	31	1689/02	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
18	31	1706/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
19	32	1730/02	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
20	33	1758/01	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mungon
21	42	2187/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
22	42	2216/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
23	42	2220/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
24	43	2157/00	Kryetar Bashkie;	Mosplotësim
25	43	2202/00	Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
26	43	2209/00	Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
27	43	2209/00	Kryetar Bashkie;	Mungon
28	45	2571/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
29	46	2541/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
30	46	2549/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
31	47	2407/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
32	54	2804/00	Këshilli Bashkiak; Kryetar Bashkie;	Mosplotësim
33	54	2825/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
34	56	2934/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mungon
35	56	2961/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
36	57	3167/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
37	57	3171/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mungon
38	63	3349/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim

39	64	3414/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
40	64	3515/01	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
41	71	3763/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
42	73	4104/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
43	74	3654/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
44	83	4415/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
45	83	4425/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim
46	85	4455/01	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mungon
47	87	4611/00	Kryetar Bashkie; Këshilli Bashkiak;	Mosplotësim

Referuar tabelës së mësipërme u konstatua se në 8 QV, në krahasim me 21 QV në zgjedhjet e vitit 2021, mungon Libri i Protokollit të Mbledhjeve (LPM) në kutinë e materialeve zgjedhore veprime që bëjnë me përgjegjësi të drejtpërdrejtë sekretarin e KQV-së.

Neni 41 i Kodit Zgjedhor përcakton detyrimin e sekretarit të KQV-së për pasqyrimin e vendimmartjes së KQV-së në Librin e Protokollit të Mbledhjeve. Neni 41 i Kodit Zgjedhor ngarkon me përgjegjësi Sekretarin e KQV-së për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KQV-së, i cili protokollon ankesat, kërkesat, dhe njoftimet drejtuar KQV-ve, regjistron në LPM vendimet e KQV-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara, regjistron në protokoll marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore, përgjigjet për vendosjen e materialeve zgjedhore në kutinë e materialeve të votimit dhe vulosjen e saj me kode sigurie.

Për 47 rastet e evidentuara me mosplotësim të Librit të Protokollit të Mbledhjeve apo të mungesës së tij, administrata e KQZ-së në përputhje me rekomandimin e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve në vendimin nr. 1/2022 si dhe me nenin 42 dhe 87 të Kodit të Procedurave Administrative, u ka kërkuar shpjegime sekretarëve lidhur me gjetjet e evidentuara nga grupet e këqyrjes a posteriori.

Nenet 41, 101/1/e dhe 113/5, përcaktojnë rregullin për administrimin e procesverbaleve, librit të protokollit të mbledhjeve (LPM) të KQV-së. Sipas këtij rregulli, LPM vendoset dhe mbyllet në kutinë e materialeve zgjedhore së bashku me origjinalet e vendimeve të KQV-së (të inkoporuara në LPM).

Gjatë komunikimit me sekretarët e KQV-ve u evidentua se:

- emërimet e sekretarëve të QV-vë ne pjesën më të madhe të këtyre QV-ve janë emëruar një ditë para ditës së zgjedhjeve duke mos ju dhënë mundësi trajnimi.
- në disa raste sekretarët e emëruar ishin me arsim 8 vjeçar apo mbi moshën 65 vjeç.

Gjatë sqarimeve të dhëna nga sekretarët e qendrave të votimit në lidhje me mosadministrimin e LPM-së,

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



Raport mbi gjetjet e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe e të materialit zgjedhor të përdorura nga komisionet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24.09.2023.

rezultojnë situata e mëposhtme:

- a. janë vendosur në kutinë e votimit të cilat janë hapur gjatë procesit të numërimit të votave ose u janë dorëzuar dorazi KZAZ-së ose
- b. ky material zgjedhor është dëmtuar/ në mungesë ose
- c. është dorëzuar në KZAZ dorazi (për të cilën kjo e fundit nuk kishte evidentuar këtë fakt në Procesverbalin e konstatimit)

Nga hetimi i zhvilluar, deduktohet se mund të jemi përpara një gabimi njerëzor për shkak se nuk janë shfaqur të dhëna që synojnë të fshehin shkelje apo që çënojnë standardin e zgjedhjeve në këto qendra votimi.

- *Lista e zgjedhësve*

Lista e zgjedhësve është përdorur në 70% të rasteve në krahasim me 57 % të rasteve të evidentuara në zgjedhjet e vitit 2021. Në 29% të qendrave të votimit të këqyruara, nga ana e komisioneve të qendrave të votimit nuk është respektuar kërkesa për të vendosur vizën mbi emrin e zgjedhësit.

Konkluzion: Nga tërësia e treguesve të performancës së KQV-ve për kategorinë e administrimit dhe pasqyrimin të vendimarrjes në librin e protokollit të mbledhjeve komisionet e qendrave të votimit në 526 QV të këqyruara kanë vepruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në nivelin mesatar 93%<sup>3</sup> të tyre.

## Seksioni 2. Administrimi i bazës materiale zgjedhore

- Vulat e komisionit të qendrës së votimit dhe vulat me kodet e sigurisë, përdorimi i zarfeve specifike


Administrimi i bazës materiale zgjedhore gjatë ditës së votimit është një tjetër kategori e vlerësimit të performancës së administratës zgjedhore. Në seksionin e pyetjeve të adresuara për mënyrën e administrimit të materialit zgjedhor evidentohet kjo situatë:

- a. 99% e kutive janë vulosura në mënyrën e duhur
- b. Në 3% QV ka shenja dëmtimi të kutive të votimit (jo detyrimisht gjatë procesit të zgjedhjeve);
- c. Në 10% të QV-ve PV i hapjes dhe ai i mbylljes nuk janë futur në kutinë e votimit por në kutinë e materialeve të votimit;
- d. Në 93% të QV-ve, janë dorëzuar vulat me kodet e sigurisë me procesverbal të veçantë, në të cilin shënohen kodet e sigurisë për çdo vulë.
- e. Në mesatarsisht 19% të QV-ve raporti i hapjes dhe ai i mbylljes së PEI nuk është administruar në KQV
- f. Në 20 % të QV-ve raporti i mbylljes nuk është nënshkruar nga operatori apo anëtarët e QV-ve
- g. Në 48 raste është vërejtur mungesa e zarfit me nënshkrime biometrike në KQV;
- h. Në 85% të QV-ve fletët e votimit janë sistemuar në zarfe sipas subjekteve zgjedhore.
- i. Në 45 QV (8% e kampionaturës) nuk është administruar nga KQV në Kutitë e Materialeve të Votimit (KQV) zarfi “VËRTETIME TË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE”.

<sup>3</sup> 7% e QV-ve të këqyruara rezultojnë me mosplotësim të LPM-së. 1% e QV-ve nuk ka administruar LPM-në në kutitë e materialeve të votimit.


- j. Në 34% të QV-ve në Kutinë e Votimit për kryetar nuk është administruar procesverbali KQZ-00-08 dhe KQZ-00-07 por kopje e tyre.

Rezultoni që procesverbalet nuk janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KQV-se të emëruar, referuar listpagesave/ informacioneve të dërguara nga KZAZ-të.



U konstatua se në 8 QV nuk është administruar Libri i Protokollit të Mbledhjeve.

Në kutinë e materialeve zgjedhore rezultojnë që janë administruar përgjithësisht dokumentet e mëposhtëm nga ana e KQV-së:



Konkluzion: Në mesatarisht 93% të QV-ve baza materiale dhe dokumentacioni zgjedhor është administruar në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe vendimit 11 / 2021 të KQZ-së.


### Seksioni 3. Verifikimi i saktësisë së veprimtarisë së grupeve të numërimit përgjatë vlerësimit e numërimit të votave

KQZ në përputhje me përcaktimet e nenit 167/2 të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit 800/2023 “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore”, këqyri saktësinë e vlerësimit dhe numërimit të votave.

Grupet e këqyrjes vlerësuan dhe numëruan votat për subjektet dhe për kandidatët e listave shumemërore të subjekteve zgjedhore.


Devijimi në vota	# QV për Këshill	# QV për Kryetar	# QV Total	Ne % nga Totali i këqyruar
1-9	108		108	21.5%
10-19	12		12	2.3%
20-29	6		6	1%
30-39	2	1	3	0.5%
40-49	1		1	0.2%
50-60	1		1	0.2%
<b>QV Total</b>	<b>130</b>	<b>1</b>	<b>131</b>	<b>25.7 %</b>

Nga këqyrja paszgjedhore në përfundim të procesit të numërimit të votave për subjektet zgjedhore / rezultuan se:



Ndërsa saktësia e numërimit për kandidatë për kryetar bashkie ishte më e lartë ku është evidentuar vetëm një QV me devijim standard/ relativ.

## SAKTESIA E NUMERIMIT TE VOTAVE NGA GNV KRAHASIM 2021 VS 2023



Nga datat 07.01.2024 deri me 31.1.2024 u zhvillua procesi, i hetimit administrativ duke identifikuar dhe më pas duke kërkuar sqarime anëtarëve të GNV-ve. Secilit prej personave, pjesë e grupeve të numërimit, iu komunikuan gjetjet nga procesi i këqyrjes dhe u kërkuan shpjegime/argumente nga ana e tyre lidhur me mospërputhjet sipas aneksit nr. 3, pjesë e këtij raporti, me qëllim vlerësimin e të gjitha rrethanave të nevojshme për vlerësimin përfundimtar. Informacioni ju është dërguar shkresërisht dhe/ose nëpërmjet platformave të komunikimit social ehatsapp/postë elektronike (e-mail).

Janë administruar përgjigjet e anëtarëve dhe për çdo rast është bërë arsyetimi i gjetjeve mbi argumentet e dhëna të detajuara në aneksin nr. 3, pjesë e raportit.

Vlerësohet se pasaktësitë deri në 20 vota do të konsiderohen gabime njerëzore duke ju referuar për analogji standardeve teknike, kushteve të punës, volumit të fletëve të votimit, natyrës së procesit dhe afateve kohore që dikton Kodi Zgjedhor për tabulimin e rezultateve.

Konstatohet se nga ana e anëtarëve të 11 grupeve të numërimit gjatë ushtrimit të detyrës nga ana e tyre janë shkelur dispozitat e nenit 116-119 të Kodit Zgjedhor. Në përfundim të procesit të vlerësimit rast pas rasti bëhen rekomandimet për propozim për sanksione administrative ndaj anëtarëve të grupeve të numërimit.

### Seksioni 4: Votat e pavlefshme dhe natyra e pavlefshmërisë


Nga administrimi i të dhënave të grupeve të këqyrjes për votat e pavlefshme rezultoi se natyra e votave të pavlefshme në përqindje janë sipas këtyre kategorive:

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm




Raport mbi gjetjet e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe e të materialit zgjedhor të përdorura nga komisionet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24.09.2023.





Të pasqyruar në mënyrë grafike :



### **Kreu III: Pilotimi i Pajisjes Elektronike të Votimit dhe Numërimit**

Pajisja elektronike e Votimit dhe e numërimit u implementua në zgjedhjet e datës 14 maj 2023 në 7 KZAZ-të e bashkive Elbasan (4 KZAZ), Kamëz (2 KZAZ) dhe Vorë ( KZAZ). Në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 167/2 pika 3 e Kodit Zgjedhor për këto ZAZ u përzgjedhën në mënyrë rastësor 40 qendra votimi Bashkia Elbasan 23 QV, Bashkia Kamëz 113 QV dhe Bashkia Vorë 4 QV, që përfaqësonin kampionaturën prej 10%.

Në përfundim të procesit u konstatua se në të gjitha QV-të rezultati i tabuluar nga sistemi ishte i njëjtë me fletët e votimit të gjetura në kutinë e fletëve të printuara nga sistemi.

### **Kreu IV: Rekomandime**

Në përfundim të procesit të këqyrjes duke marrë në konsideratë problematikat e evidentuara dhe të referuara edhe në këtë raport, rekomandohet marrja e masave të cilat synojnë rritjen e efikasitetit dhe vendimarrjes së administratës zgjedhore të nivelit të tretë, rritjen e llogaridhënies dhe përmirësimin e kushteve të punës. Njëkohësisht, për shkeljet e konstatuara përgjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave nga anëtarët e GNV-ve, rekomandohet vijimi i procedurave të mëtejshme administrative për vendosjen e sanksioneve administrative për shkeljet e konstatuara<sup>4</sup>.

#### **Seksioni 1: Masa për adresimin e problematikave të identifikuara gjatë procesit të votimit dhe numërimit të votave**

- 1. Për anëtarët e grupeve të numërimit të votave**
  - Propozimi i masave administrative me gjobë nga **3,000 lekë deri në 90,000 lekë** për ata që kanë shkelur nenet 116-119 të Kodit Zgjedhor dhe kanë marzh gabimi më shumë se 20 vota.
- 2. Për komisionet e qendrave të votimit**
  - Rishikimi i proceseve të punës dhe akteve rregullatore për të reduktuar volumin dokumentar dhe për të përmirësuar transparencën e vendimeve të KQV-së.
  - Rishikimi i masës së shpërblimit për ta përshtatur me standardet rajonale.
  - Identifikimi i anëtareve të KQV-së që kanë administruar procesin nëpërmjet plotësimit të listë prezencës.
- 3. Për administratën zgjedhore të nivelit të dytë (Komisionet e Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve)**
  - Rishikimi i proceseve të punës dhe akteve rregullatorë/normative për të garantuar integritetin dhe përdorimin e teknologjisë për përmirësimin e procesit

<sup>4</sup> Sugjerohet që Kodi Zgjedhor apo aktet nënljigjore të përmirësohen duke saktësuar rastet dhe llojet e masave disiplinore që mund të merren ndaj anëtarëve të komisioneve zgjedhore dhe periudhën e parashkrimit të tyre.

vendimmarrës në KZAZ.

- Sigurimi që të gjithë anëtarët e KQV-së të identifikohen dhe të njihen për KZAZ-të, duke përfshirë zhvillimin e mekanizmave dhe mjeteve teknologjike për menaxhimin më të mirë të administratës së KQV-së dhe GNV-së.

**4. Për trajnimin e personelit zgjedhor**

- Zhvillimi i programeve të trajnimit për personelin e angazhuar në proceset zgjedhore në nivel qendror dhe vendor për të përmirësuar aftësitë dhe njohuritë e tyre.
- Qasje proaktive në trajnimin për procedurat e numërimit të votave për të zvogëluar gabimet njerëzore dhe shtimi i alternativave të trajnimeve për grupet e numërimit të votave, vëzhguesit e subjekteve dhe KZAZ-në.
- Kuvendi të parashikojë dispozita detyruese për Këshillin e Ministrave të vendosë në dispozicion të KQZ-së fonde të mjaftueshme për organizimin e trajnimeve jashtë periudhave zgjedhore në vitet jozgjedhore.

**5. Për udhëzimet e administratës zgjedhore**

- Përsosja e udhëzimeve të detajuara dhe të qarta për të ndjekur saktë procedurat dhe për të shmangur gabimet ose moskuptimin e procesit, nëpërmjet plotësimit të pyetje-përgjigjeve më të shpeshta.

**6. Për monitorimin e veprimitarisë së administratës zgjedhore**

- Vendosja e një mekanizmi eficient për monitorim të vazhdueshëm për të evidentuar dhe korrigjuar çdo gabim.
- Përmirësimi i strukturave organizative dhe investimi në kapacitetet e punonjësve për ndërtimin e kapaciteteve institucionale për mbikëqyrjen efektive të procesit zgjedhor.

**7. Për teknologjinë në procesin e numërimit të votave:**

- Investimi në teknologji për monitorimin e procesit dhe sigurimin e transparencës dhe saktësisë së rezultateve.

**8. Për menaxhimin e lodhjes së personelit zgjedhor:**

- Organizimi i një sistemi rotacioni për anëtarët e grupit të numërimit për të siguruar pushim dhe rikuperim.
- Shtimi i grupeve të numërimit me qëllim vlerësimin dhe shpalljen në kohë të rezultatit të zgjedhjeve dhe uljen në masë të gabimeve njerëzore përgjatë procesit të numërimit.
- Mundësimin e shtimit të tavolinave të numërimit me minimumin 30% për çdo KZAZ.
- Përmirësimi i kritereve për mjediset e punës së administratës zgjedhore duke i kushtuar vëmendje faktorëve të tillë si ndriçimi, ajrosja dhe/ose kondicionimi, hapësirës minimale të punës për çdo anëtar të grupit të numërimit.

## Seksioni 2: Masa për përmirësime ligjore dhe akteve nënligjorë

1. **Për depolitizimin e administratës zgjedhore dhe mirëadministrimin e dokumentacionit zgjedhor:**
  - T'i kërkohet Kuvendit të Shqipërisë të bëjë përmirësimin e dispozitave ligjore për depolitizimin e administratës zgjedhore, për të garantuar që administrimi i dokumentacionit zgjedhor të kryhet nga personel i kualifikuar nga KQZ.
2. **Për zëvendësimin e administratës zgjedhore:**
  - Vendosja e kriterëve shtërnguese për pjesëmarrjen në trajnim të administratës zgjedhore dhe kufizimeve kohore për zëvendësimin e tyre.
3. **Për shmangien e pavlefshmërisë së votës:**
  - Konsiderimi i alternativave për përdorimin e materialeve zgjedhore të posaçme në dhomën e fshehtësisë për të bërë përzgjedhjen/markimin e votës.
  - Rritja e sanksioneve për kryetarët dhe sekretarët që nuk vendosin vula pas fletës së votimit duke e identifikuar këtë veprim si kundërvajtje administrative.
  - Të përfshihen në Kodin Zgjedhor dispozita për administrimin e fletëve të votimit të papërdorura, duke parashikuar që ato të markohen në QV dhe të vendosen në zarf për të mënjeluar keqadministrimin e tyre.

**Aneksi nr. 1: Qendrat e Votimit të përzgjedhura me short**

ZAZ	QV	Këqyrur nga KAS	PEVN	Total
ZAZ 01	0005/00			1
	0025/00			1
	0026/00			1
	0027/00			1
	0041/01			1
	0042/00			1
	0075/00			1
ZAZ 02	0077/00			1
	0102/01			1
	0107/00			1
	0113/01			1
	0118/00			1
	0119/00			1
	0216/00			1
	0332/00			1
	0336/00			1
	0344/00			1
	0345/00			1
ZAZ 03	0290/00			1
	0291/00			1
	0292/00			1
	0294/01			1
	0301/00			1
ZAZ 04	0248/00			1
	0250/00			1
	0263/00			1
	0316/00			1
	0321/00			1
ZAZ 05	0275/01			1
	0307/01			1
	0309/01			1
	0310/00			1
	0314/01			1
ZAZ 06	0162/00			1
	0165/00			1
	0170/00			1
	0172/00			1
	0210/00			1

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



Raport mbi gjetjet e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe e të materialit zgjedhor të përdorura nga komisionet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24.09.2023.

ZAZ 07	0390/00			1
	0391/00			1
ZAZ 08	0388/00			1
	0399/00			1
ZAZ 09	0447/00			1
	0462/00			1
	0465/00			1
	0518/00			1
ZAZ 10	0547/00			1
	0560/01			1
	0565/00			1
ZAZ 11	0576/00			1
	0608/00			1
	0615/00			1
	0630/00			1
	0647/00			1
	0650/01			1
	0655/00			1
ZAZ 12	0681/00			1
	0729/02			1
	0729/03			1
	0730/00			1
	0737/00			1
	0741/01			1
ZAZ 13	0695/00			1
	0705/01			1
	0706/00			1
	0725/00			1
	0727/00			1
	0745/01			1
	0747/01			1
ZAZ 14	0775/00			1
	0800/00			1
	0816/01			1
	0842/00			1
	0895/00			1
ZAZ 15	0859/00			1
	0863/00			1
	0865/00			1
	0899/01			1
	0900/00			1
	0913/01			1
	0918/00			1

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



Raport mbi gjetjet e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe e të materialit zgjedhor të përdorura nga komisionet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24.09.2023.

ZAZ 16	0927/00			1
	0937/00			1
	0983/00			1
	1018/00			1
	1020/00			1
ZAZ 17	0995/00			1
	1000/00			1
	1028/00			1
ZAZ 18	1035/00			1
	1036/01			1
	1057/00			1
	1065/00			1
	1087/00			1
ZAZ 19	1105/00			1
	1107/00			1
	1111/00			1
	1135/00			1
	1170/00			1
	1175/00			1
	1185/00			1
	1195/00			1
	1206/00			1
	1238/00			1
ZAZ 20	1277/00			1
	1278/01			1
	1285/01			1
	1298/00			1
	1306/00			1
	1307/01			1
	1311/00			1
	1313/00			1
	1317/00			1
ZAZ 21	1348/00			1
	1349/00			1
	1353/00			1
	1354/01			1
	1359/01			1
	1367/01			1
	1368/01			1
	1378/01			1
	1379/01			1
	1385/00			1
	1518/00			1

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



Raport mbi gjetjet e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe e të materialit zgjedhor të përdorura nga komisionet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24.09.2023.

ZAZ 22	1410/02			1
	1419/00			1
	1420/05			1
	1458/01			1
	1468/02			1
	1468/04			1
	1469/03			1
	1470/06			1
ZAZ 23	1429/01			1
	1472/02			1
	1474/01			1
	1476/00			1
	1486/00			1
	1489/00			1
	1492/00			1
	1492/01			1
ZAZ 24	1426/00			1
	1428/03			1
	1432/03			1
	1453/01			1
	1455/01			1
	1457/02			1
	1498/00			1
ZAZ 25	1338/00			1
	1387/00			1
	1389/01			1
	1398/00			1
	1401/00			1
ZAZ 26	1555/01		PEVN	1
	1559/00		PEVN	1
	2037/00		PEVN	1
	2038/02		PEVN	1
ZAZ 27	1564/01		PEVN	1
	1566/00		PEVN	1
	1569/00		PEVN	1
	1580/01		PEVN	1
	1582/01		PEVN	1
	1583/01		PEVN	1
	1584/01		PEVN	1
	1590/00		PEVN	1
	1600/03		PEVN	1
ZAZ 28	2040/01		PEVN	1
	2043/01		PEVN	1

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



Raport mbi gjetjet e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe e të materialit zgjedhor të përdorura nga komisionet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24.09.2023.



	2044/03		PEVN	1
	2051/02		PEVN	1
ZAZ 29	1533/01			1
	1537/02			1
	1541/02			1
	1542/00			1
	1544/00			1
	1649/00			1
	2069/00			1
	2074/00			1
	2104/00			1
	2116/00			1
	2120/00			1
ZAZ 30	1615/04			1
	1615/05			1
	1616/00			1
	1624/00			1
	2055/00			1
	2057/00			1
	2079/00			1
	2082/00			1
	2084/06			1
ZAZ 31	1681/00			1
	1682/01			1
	1689/02			1
	1703/00			1
	1706/00			1
	1707/01			1
ZAZ 32	1708/01			1
	1712/00			1
	1712/01			1
	1716/00			1
	1722/01			1
	1723/04			1
	1727/00			1
	1728/01			1
	1730/02			1
ZAZ 33	1749/00			1
	1758/01			1
	1761/00			1
	1761/01			1
	1769/00			1
ZAZ 34	1783/01			1

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



Raport mbi gjetjet e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe e të materialit zgjedhor të përdorura nga komisionet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 dhe për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Kukës të datës 24.09.2023.

	1785/02			1
	1788/01			1
	1789/00			1
	1794/00			1
	1796/00			1
	1800/01			1
ZAZ 35	1828/00			1
	1828/01			1
	1830/01			1
	1840/00			1
	1840/01			1
	1844/03			1
	1845/09			1
	1854/00			1
	1855/00			1
ZAZ 36	1860/00			1
	1868/01			1
	1869/01			1
	1877/02			1
	1879/00			1
	1879/02			1
	1881/01			1
ZAZ 37	1882/00			1
	1890/01			1
	1900/00			1
	1901/01			1
	1905/01			1
	1907/00			1
	1920/01			1
	1920/02			1
